

Vendim nr. 90 datë 27.04.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Fiona Papajorgji,	Anëtare
Sonila Bejtja,	Anëtare

në datën 24.04.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 2 (L) 2023 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: LUKE TUCI

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2022-2141, datë 13.09.2022 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, pika 1, 11, pika 3, 15, 17, pika 1, 18, pikat 1 dhe 2, 35, pika 3, 41, pika 1, 42, 43, 116, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i”, 142, pika 1 dhe 146 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja Luke Tuci ka qenë në marrëdhënie pune në Bashkinë Laç që nga viti 1993, në disa pozicione të ndryshme. Me vendimin nr. 5, datë 01.03.2004 të kryetarit të Bashkisë Laç ajo është konfirmuar nëpunëse civile dhe me urdhrin nr. 127, datë 31.12.2008

“Për emërim në detyrë” të kryetarit të Bashkisë Laç, ajo është emëruar punonjëse sporteli në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, Bashkia Laç.

2. Me vendimin nr. 125 prot., datë 22.01.2014 të palës së paditur, Bashkisë Laç, kërkesja është njoftuar për lirim nga detyra. Duke mos qenë dakord me këtë vendim, ajo i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me kërkesëpadi.

3. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 1404, datë 03.04.2014, ka vendosur: “*Rrëzimin e kërkesëpadisë së paditëses Luke Tuci, të paditur Bashkia Laç dhe Qendra Kombëtare e Regjistrimit, me objekt: “Kthim në punë. Konstatimin e zgjidhjes së menjëhershme e të pajustificuar të kontratës së punës. Detyrimin e të paditurit, QKR-së për shpërblimin e paditëses me 12 (dymbëdhjetë) muaj pagë për zgjidhje të menjëhershme e të pajustificuar të kontratës së punës. Detyrimin e të paditurit, për shpërblimin e paditëses me 3 (tre) muaj pagë për mosrespektim të afatit të njoftimit. Detyrimin e të paditurit, për shpërblimin e paditëses me 2 (dy) paga mujore për mosrespektim të procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës. Detyrimin e të paditurit, për shpërblimin e paditëses për vjetërsinë në punë me 2.5 paga mujore, për periudhën nga data 22.10.2008 deri më datë 27.01.2014.”*. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim kërkesja.

4. Me vendimin nr. 4165, datë 12.11.2014, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur: “*Prishjen e vendimit nr. 1404, datë 03.04.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe pushimin e gjykimit të çështjes.*”. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs në datën 03.03.2015 kërkesja Luke Tuci.

5. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-2141, datë 13.09.2022, ka vendosur mospranimin e rekursit, me argumentin se nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar.

6. Në datën 17.02.2023 (sipas shënimit të shërbimit postar), kërkesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual, i cili është plotësuar në datën 24.02.2023, duke kërkuar shfuqizimin e vendimit sipas objektit.

II

Pretendimet e kërkueses

7. **Kërkesja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor në aspektet e mëposhtme:

7.1. *E drejta për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka marrë në shqyrtim asnjë nga pretendimet dhe shkaqet e rekursit, pavarësisht se

në vendim është shprehur se Gjykata Administrative e Apelit i ka kthyer përgjigje shteruese shkaqeve të ankimit.

- 7.2. *E drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme*, pasi nga ana e Gjykatës së Lartë janë shkelur standardet për numërtimin, evidentimin dhe sistemimin e akteve në dosjen gjyqësore, si dhe mungojnë procedurat e shortimit mes trupave gjykues nr. 1 dhe nr. 2 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.
- 7.3. *E drejta për t'u dëgjuar*, pasi relacioni i gjyqtarit për shqyrtimin paraprak të çështjes nga Gjykata e Lartë nuk përmban datën ose të dhënat nëse u është shpërndarë edhe anëtarëve të tjerë të trupit gjykues, ndërkohë që gjykimi i çështjes është kryer në një hapësirë kohore prej 10 minutash. Referimi i Gjykatës së Lartë në jurisprudencën e saj pa cituar vendimmarrje konkrete i ka cenuar këtë të drejtë. Po kështu, Gjykata e Lartë nuk ka kryer shpalljen për gjykimin në dhomën e këshillimit për vendimin e revokimit, duke i mohuar asaj të drejtën për të paraqitur pretendime për këtë seancë ekstra procedurale.
- 7.4. *Parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk ka marrë parasysh asnjë nga pretendimet e parashtruara nga kërkuesja në rekurs, duke lejuar të prevalojnë argumentet e palës tjetër. Po kështu, kundërrekursi nuk rezulton i dokumentuar në listën e akteve të administruara në dosje ose t'i jetë dorëzuar relatorit të çështjes dhe anëtarëve të tjerë të trupit gjykues.
- 7.5. *Parimi i barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit*, në drejtim të standardit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, pasi në ndryshim nga çështjet e tjera të shqyrtuara në të njëjtën ditë nga Gjykata e Lartë, çështja e saj është gjykuar tej afatit të arsyeshëm.
- 7.6. *Standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar asnjë nga pretendimet e kërkueses, por është shprehur se Gjykata Administrative e Apelit në vendimin e saj i ka ezauruar dhe shteruar të gjitha pretendimet e saj, çka do të thotë se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk ka marrë në shqyrtim asnjë nga shkaqet dhe pretendimet e parashtruar në rekurs nga kërkuesja. Mungesa e arsytimit të vendimit gjyqësor ka cenuar edhe parimin e sigurisë juridike. Gjithashtu, vendimet e Gjykatës Administrative të Apelit dhe të Gjykatës së Lartë janë marrë në zbatim të gabuar të ligjit material dhe procedural. Gjykata e apelit nuk ka marrë në shqyrtim pretendimin e kërkueses, se në objektin e padisë kërkimet i janë referuar Kodit të Punës, ndërsa si bazë ligjore, përveçse këtij kodi, është cituar edhe ligji për statusin e nëpunësit civil, si dhe kërkimet në pjesën

arsyetuese të kërkesëpadisë, të pretenduara edhe në gjykim në Gjykatën Administrative të Shkallës së parë Tiranë dhe në gjykatën e apelit. Ky standard është cenuar edhe nga vendimi i Gjykatës së Lartë, pasi atij i mungon tërësisht analiza juridiko-ligjore, interpretimi i konfliktit në raport me faktet, provat dhe ligjin e zbatueshëm, si dhe nuk i ka dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimeve të kërkuases.

- 7.7. Gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit nuk kanë verifikuar shkaqet e largimit nga puna të kërkuases dhe nuk janë shprehur për të gjitha kërkimet dhe pretendimet e saj. Kërkuessa nuk e ka pasur të qartë nëse e kishte fituar statusin e nëpunëses civile, për këtë arsye ajo i ka ngritur pretendimet e saj në drejtim të Kodit të Punës dhe ligjit për statusin e nëpunësit civil. Pavarësisht këtij fakti, gjykatat kanë vlerësuar se kërkimet janë kontradiktore, pasi ato nuk mund të ngriheshin bazuar në Kodin e Punës, por në legjislacionin për nëpunësin civil. Edhe Gjykata e Lartë duhet ta shqyrtonte rekursin, pasi ai ka shkaqe të përligjura.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitetin e kërkuases

8. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

9. Në këndvështrim të verifikimit të plotësisht të këtyre kriterëve, Kolegji vlerëson se kërkuessa legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, sepse ka qenë palë në procesin gjyqësor për të cilin është marrë vendimi objekt kundërshtimi, si dhe është bartëse e të drejtave dhe lirive themelore të njohura nga Kushtetuta.

10. Për sa i takon shterimit të mjeteve juridike, Gjykata në praktikën e saj ka pranuar se në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f” të Kushtetutës, individ mund t’i drejtohet asaj për

cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike. Shterimi i mjeteve juridike nënkupton që ankuesi duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete (*shih vendimin nr. 38, datë 25.04.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Në këtë drejtim, pretendimi i kërkuësës për cenimin e parimit të barazisë para ligjit dhe diskriminimit në drejtim të standardit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, pasi në ndryshim nga çështjet e tjera të shqyrtuara në të njëjtën ditë nga Gjykata e Lartë, çështja e saj është gjykuar tej një afati të arsyeshëm, konstatohet se është parashtruar drejtpërdrejt përpara Gjykatës, duke mos shteruar paraprakisht mjetet juridike efektive që ofron legjislacioni në fuqi, në kuptim të parashikimeve të neneve 399/1 – 399/12 të Kodit të Procedurës Civile. Në jurisprudencën e saj Gjykata është shprehur se, si rregull, shqyrtimi i këtyre lloj çështjesh dhe vlerësimi përfundimtar në lidhje me kohëzgjatjen e arsyeshme të gjykimit, duhet të bëhet nga gjykatat e zakonshme, sipas kompetencës që parashikon ky kod, në përputhje me parimin e subsidiaritetit (*shih vendimet nr. 3, datë 17.02.2022; nr. 2, datë 17.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, në lidhje me këtë pretendim Kolegji çmon se kërkuësja nuk i ka shteruar mjetet juridike efektive përpara se të vinte në lëvizje këtë gjykim kushtetues.

12. Ndërsa në lidhje me pretendimet e tjera në kushtet kur nuk ka mjet tjetër ankimi kundër këtij vendimi, Kolegji vlerëson se kërkuësja i ka shteruar mjetet e ankimit në dispozicion përpara se t'i drejtohet Gjykatës, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës.

13. Lidhur me legjitimitimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000 ka parashikuar afatin 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Në rastin konkret, Kolegji vëren se vendimi gjyqësor i kundërshtuar nga kërkuësja mban datën 13.09.2022, ndërsa ankimi kushtetues individual në Gjykatë është paraqitur në datën 17.02.2023 (*sipas shënimit të shërbimit postar*). Në datën 19.10.2022, sikurse rezulton në dosjen gjyqësore, Gjykata e Lartë e ka njoftuar përfaqësuesin ligjor të kërkuësës për vendimin nëpërmjet *e-mail*-it. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor, pra përmbush edhe kriterin e legjitimitit *ratione temporis*.

14. Për sa u përket pretendimeve të kërkuësës se gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit nuk kanë verifikuar shkaqet e largimit nga puna të kërkuësës dhe nuk janë shprehur për të gjitha kërkimet dhe pretendimet e saj, edhe pse ajo i ka shteruar mjetet në dispozicion, nga mënyra se si janë ngritur këto pretendime, Kolegji vlerëson se ato kanë të bëjnë me mënyrën e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se kontrolli kushtetues ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të

drejtave kushtetuese të individit, kurse problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përfshihen në juridiksionin kushtetues nëse nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr. 38, datë 02.12.2021; nr. 6, datë 16.02.2021; nr. 9, datë 26.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*). Mënyra se si gjykatat e zakonshme kanë përcaktuar faktet dhe kanë interpretuar ligjin e zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes në shqyrtim përpara tyre, nuk përbën lëndë kushtetuese, me përjashtim të rastit kur kjo mënyrë veprimi e gjykatës së zakonshme provohet se ka cenuar të drejtat kushtetuese të individit që vë në lëvizje këtë Gjykatë, në kuptimin që procesi në tërësinë e tij rezulton haptazi i paarsyeshëm ose arbitrar (*shih vendimin nr. 38, datë 02.12.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, kërkesja nuk legjitimohet *ratione materiae* për to dhe nuk mund të merren në shqyrtim nga kjo Gjykatë.

15. Ndërsa, për sa u përket pretendimeve se relacioni i gjyqtarit për shqyrtimin paraprak të çështjes nga Gjykata e Lartë nuk përmban datën ose të dhënat nëse u është shpërndarë edhe anëtarëve të tjerë të trupit gjykues, ndërkohë që gjykimi i çështjes është kryer në një hapësirë kohore prej 10 minutash, si dhe faktit se referimi i Gjykatës së Lartë në jurisprudencën e saj është bërë pa cituar vendimmarrje konkrete, Kolegji vlerëson se ato nuk janë ngritur në nivel kushtetues, ndaj nuk mund të merren në shqyrtim.

16. Gjithashtu, në drejtim të legjitimitetit *ratione materiae*, kërkesja ka pretenduar cenimin e të drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, pasi nga ana e Gjykatës së Lartë janë shkelur standardet për numërtimin, evidentimin dhe sistemimin e akteve në dosjen gjyqësore si dhe mungojnë procedurat e shortimit mes trupave gjykues nr. 1 dhe nr. 2 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë. Për sa i takon argumenteve që lidhen me shkeljen e standardeve për numërtimin, evidentimin dhe sistemimin e akteve në dosjen gjyqësore, Kolegji vëren se kërkesja nuk i ka ngritur në nivel kushtetues, pasi ajo nuk ka arritur të përcaktojë se si, në kuptim të testit objektiv dhe atij subjektiv të paanshmërisë, është cenuar parimi i gjykimit nga një gjykatë e paanshme nga vendimmarrja e Gjykatës së Lartë. Ndërsa në lidhje me argumentet e tjera për këtë parim, Kolegji vlerëson se ato përfshihen në kompetencën e kësaj Gjykate. Po kështu, megjithëse kërkesja ka pretenduar cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj dhe parimin e barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, në thelb, argumentet e saj lidhen me standardin e arsytimit të vendimit, i cili së bashku me pretendimin e cenimit të së drejtës së gjykimit nga një gjykatë e paanshme dhe së drejtës për t'u dëgjuar do të analizohen në vijim.

B. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsytimit të vendimit

17. Kërkuesja ka pretenduar se Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar asnjë nga pretendimet e saj, por është shprehur se Gjykata Administrative e Apelit në vendimin e saj i ka ezauruar dhe shteruar të gjitha pretendimet e saj. Ky fakt tregon se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk ka marrë në shqyrtim asnjë nga shkaqet dhe pretendimet e parashtruara në rekurs nga kërkuesja. Mungesa e arsytimit të vendimit gjyqësor ka cenuar edhe parimin e sigurisë juridike. Gjithashtu, vendimet e Gjykatës Administrative të Apelit dhe të Gjykatës së Lartë janë marrë në zbatim të gabuar të ligjit material dhe procedural. Gjykata e apelit nuk ka marrë në shqyrtim pretendimin e kërkueses, se në objektin e padisë kërkimet i janë referuar Kodit të Punës, ndërsa si bazë ligjore përveç këtij kodi është cituar edhe ligji për statusin e nëpunësit civil, si dhe kërkimet në pjesën arsyetuese të kërkesëpadisë, të pretenduar edhe në gjykim në Gjykatën Administrative të Shkallës së parë Tiranë dhe në gjykatën e apelit. Ky standard është cenuar edhe nga vendimi i Gjykatës së Lartë, pasi atij i mungon tërësisht analiza juridiko-ligjore, interpretimi i konfliktit në raport me faktet, provat dhe ligjin e zbatueshëm, si dhe nuk i ka dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimeve të kërkueses.

18. Gjykata ka theksuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimin nr. 10, datë 04.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe në shërbim e funksion të njëra-tjetrës (*shih vendimin nr. 16, datë 16.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Në përputhje me këto standarde, konstatohet se vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë ka arsyetuar se: “... nuk ngrihen problematika në rekurs që të bëjnë të mendohet se gjykatat më të ulëta kanë zbatuar gabim ligjin material apo procedural dhe që ky keq zbatim të jetë i një rëndësie themelore për njehsimin, sigurinë dhe/ose zhvillimin e praktikës gjyqësore” (*shih paragrafin 9 të vendimit të Gjykatës së Lartë*) si dhe në vijim “... pjesa e pretendimeve në rekurs që ngre çështje të vlerësimit të provave, del jashtë juridiksionit rishikues dhe ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë. Nëpërmjet rekursit dhe gjykimit në Gjykatën e Lartë nuk mund të pretendohet të rihapet edhe një herë shqyrtimi gjyqësor i

provave. Për këtë fazë të gjyimit shqyrtimi gjyqësor është i mbyllur dhe prekluzohet pas shqyrtimit të çështjes në gjykatën e apelit.” (shih paragrafin 10 të vendimit).

20. Nga sa më lart, konstatohet se vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë përmban të dhënat e palëve, rrethanat e çështjes, arsyetimin dhe vendimmarrjet e gjykatave më të ulëta, ligjin e zbatueshëm, si dhe pjesën arsyetuese ku gjykata mbështet qëndrimin e saj të shprehur në dispozitiv. Vendimi nuk rezulton të jetë alogjik, kontradiktor, i pamjaftueshëm, ose në mungesë të elementeve formale të parashikuara nga dispozitat ligjore dhe standardet e vendosura nga jurisprudenca e Gjykatës. Gjithashtu, pretendimet e kërkuases janë pasqyruar në vendimin e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë (*shih paragrafin 7 të vendimit*) dhe janë analizuar sipas jurisprudencës së Gjykatës për këtë qëllim. Në këtë drejtim, arsyetimi i kufizuar i vendimeve në praktikën e Gjykatës së Lartë nuk përbën cenim të këtij standardi, përderisa shpreh në thelb shkaqet e mospranimit të rekursit gjatë shqyrtimit të tij paraprak në dhomën e këshillimit.

21. Për pasojë, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuases për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor është haptazi i pabazuar.

C. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për t’u dëgjuar

22. Kërkuësja ka pretenduar se Gjykata e Lartë nuk ka kryer shpalljen për gjykimin në dhomën e këshillimit për vendimin e revokimit, duke i mohuar asaj të drejtën për të paraqitur pretendime për këtë seancë ekstra procedurale.

23. Gjykata ka vlerësuar se e drejta e palëve për të qenë të pranishme, për t’u mbrojtur e për t’u dëgjuar në procesin gjyqësor janë aspekte të rëndësishme të procesit të rregullt në kuptimin kushtetues (*shih vendimin nr. 23, datë 20.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjithashtu, Gjykata në jurisprudencën e saj ka përcaktuar disa standarde kushtetuese, të cilat janë të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën në mënyrë të tillë që cenimi i njërit standard ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e të tjerave. Konkretisht, e drejta për t’u njoftuar për një gjykim dhe pjesëmarrja në të është e lidhur me vendimmarrjen e gjykatës, e cila ndikon drejtpërsëdrejti mbi të drejtat subjektive ose interesat e ligjshme të individit. E drejta për t’u njoftuar për të marrë pjesë në gjykim u paraprin të drejtave të tjera, pasi nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës, në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 37, datë 30.06.2016; nr.31, datë 26.05.2014; nr. 21, datë 04.04.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Në rastin konkret, Kolegji vëren se Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje nëpërmjet rekursit të paraqitur nga vetë kërkuësja, i cili është regjistruar në datën 03.03.2015. Kolegji

Administrativ i Gjykatës së Lartë, në datën 21.07.2022, ka vendosur caktimin e seancës në dhomën e këshillimit. Në ndryshim nga sa pretendon kërkuesja, referuar akteve të ndodhura në dosjen gjyqësore, nuk rezulton që çështja e saj të jetë shqyrtuar më parë në dhomën e këshillimit dhe as që të jetë vendosur “kalimi i çështjes në seancë gjyqësore”. Për rrjedhojë, për kërkuesen nuk ka pasur më parë një vendim të tillë të ndërmjetëm, por shqyrtimi i çështjes është bërë për herë të parë në datën 13.09.2022, kur Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë e ka shqyrtuar rekursin në dhomën e këshillimit, duke vendosur mospranimin e tij. Po kështu, Gjykata e Lartë, në datën 21.07.2022, ka bërë shpalljen e datës së shqyrtimit të çështjes në dhomën e këshillimit nëpërmjet afishimit në ambientet e kësaj gjykate dhe në faqen zyrtare, duke caktuar datën 13.09.2022 për shqyrtimin e saj.

25. Për pasojë, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkueses për cenimin e së drejtës për t’u dëgjuar është haptazi i pabazuar.

Ç. Për pretendimin e cenimit të parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme

26. Kërkuesja ka pretenduar se në dosjen gjyqësore të Gjykatës së Lartë mungojnë procedurat e shortimit mes trupave gjykues nr. 1 dhe nr. 2 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, duke cenuar në këtë mënyrë parimin e gjykimit nga një gjykatë e paanshme.

27. Neni 42, pika 2, i Kushtetutës parashikon se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

28. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se parimi i paanshmërisë ka në vetvete elementin e vet *subjektiv*, i cili lidhet ngushtë me bindjen e brendshme që krijon gjyqtari për zgjidhjen e çështjes në gjykim, si dhe elementin *objektiv*, me të cilin kuptohet dhënia e garancive të nevojshme për gjykim të paanshëm nga vetë gjykata, përmes mënjanimit nga vetë ajo të çdo dyshimi të përligjur në këtë drejtim. Ndër të tjera, gjykata merr parasysh veçanërisht problemin e përbërjes së trupit gjykues, në mënyrë që të mënjanohen nga gjykimi i çështjes gjyqtarët që nuk kanë garancitë e kërkuara për paanshmëri në kuptimin objektiv. Gjykata çmon se paragjykimimi eventual për paanshinë e gjyqtarit mund të ngrihet në hipotezën se gjyqtari është shprehur në një procedim tjetër me një vlerësim që ka të bëjë me përmbajtjen e të njëjtit fakt, në lidhje me të njëjtin subjekt. Në shtetin e së drejtës, kërkesa për gjykim të paanshëm merr rëndësi të veçantë në funksion të besimit në dhënien e drejtësisë, që në shoqëritë demokratike duhet ta krijojnë në çdo rast jo vetëm palët në gjykim, por dhe çdo qytetar i thjeshtë (*shih vendimet nr. 24, datë 11.10.2022; nr. 15, datë 11.03.2021; nr. 6, datë 29.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Në rastin konkret, Kolegji vëren se referuar dosjes gjyqësore me aktin nr. s'ka, për kalimin e çështjes gjyqësore gjyqtarit të caktuar është përcaktuar përbërja e trupit gjykues për shqyrtimin e çështjes së kërkuases, bazuar në vendimin nr. 8, datë 25.03.2022 “Për caktimin e gjyqtarëve në përbërje të kolegjeve të Gjykatës së Lartë, si dhe caktimin e gjyqtarëve në përbërje të trupave gjykues të secilit kolegji” të Gjykatës së Lartë. Ky vendim rezulton i publikuar edhe në faqen zyrtare të kësaj gjykate. Në këto rrethana, Kolegji vlerëson se caktimi i gjyqtarit relator në çështjen e kërkuases është kryer në përputhje me rregullat procedurale sipas vendimit të lartpërmendur, për rrjedhojë pretendimi i saj për cenimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme është haptazi i pabazuar.

30. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.